



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr. 3329/1 Prot.

Tiranë, më 9.10.2023

NJOFTIM PËR VENDE PUNE

A. Konkurs për Pranim në Kategorinë e Mesme Drejtuese në pozicionin Ndhmës Inspektor

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.5.2013 *"Për Nëpunësin Civil"*, i ndryshuar, Kreu V – *"Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë"*, neni 26 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015, *"Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese"*, i ndryshuar, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se:

a) Në administratën e tij ka 2 (dy) vende të lira pune të nivelit të mesëm drejtues, në pozicionin Ndhmës Inspektor.

Paga e pozicionit- II-1

Në përputhje me Vendimin nr. 90, datë 22.12.2022 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.55/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave"*, të ndryshuar.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil, me procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë.

b) Pëshkrimi i detajuar i vendit të punës

Ndhmës Inspektori në ILDKPKI, merret me mbledhjen e të dhënave, kryerjen e hetimeve dhe kërkimeve administrative rreth deklarimeve të subjekteve që kanë detyrim ligjor për deklarim dhe personave të lidhur me ta, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar; ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 *"Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, i ndryshuar, ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016, *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*, i ndryshuar, akteve nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm dhe Kodit të Procedurave



ILDKPKI

Rr."Reshit Çollaku", Tiranë, Shqipëri, Tel. + 355 42 259 461, www.ildkpi.al, info@ildkpi.al

Administrative. Është përgjegjës për sigurimin e informacionit nga media, shoqëria civile, publiku e të tjerë për rastet e fshehjes së pasurisë dhe rasteve të konfliktit të interesave për zyrtarët që ushtrojnë funksionet publike, për mbledhjen, menaxhimin, përpunimit, analizimit të të dhënave financiare, ekonomike dhe/ose statistikore, apo koordinimit e organizimit të marrëdhënieve me organizata dhe/ose institucione vendase ose të huaja. Përgatitja e materialit informues për Inspektorin e Përgjithshëm.

c) Kërkesat e Përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

LËVIZJA PARALELE BRENDË TË NJËJTËS KATEGORI

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori.

ç) Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon (kategoria II/1).
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi. (Të vërtetuar me një dokument nga institucioni).
- Të ketë dy vlerësimet e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

d) Kërkesat specifike që duhet të plotësojë kandidati

- Arsimit të lartë në shkencat Juridike dhe/ose Ekonomike me diplomë “Master i Shkencave” apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Të ketë një ekperiencë pune mbi 3 vjet në profesion dhe të ketë përvojë pune në fushat: juridike, financiare, bankare, tatimore, investigative dhe ato analitike;
- Të ketë njohuri të mira në një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze;
- Të jetë individ me personalitet dhe integritet, me aftësi shumë të mira gjykimi, analitike, hetimi dhe iniciativë për të marrë vendime komplekse;
- Të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
- Trajnime në lidhje me fusha që trajtojnë çështjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, si dhe të administratës publike në tërësi, Auditimit, ekspertizës së Vlerësimit të Pasurive etj.
- Aftësi të drejtimit të punës në grup, aftësi gjykimi dhe hartimit të dokumentave të ndryshëm.

dh) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje të jetëshkrimit (C.V.);
3. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet t'a ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
4. Fotokopje e listës së notave;
5. Një fotokopje e librezës së punës e plotësuar;
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore;
7. Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera, të përmendura në jetëshkrimin e tij;
9. Fotokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitje e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër brenda datës 23.10.2023.

e) Mënyra e shqyrtimit dhe shpallja e rezultateve të verifikimit paraprak

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

- Verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë.
- Vlerësimi i kandidateve, ku përfshihet vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervistën e strukturuar me gojë.

ë) Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **25.10.2023** do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, e cila do të shpallet në portalin "*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*", si dhe faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al. Këta do të jenë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për lëvizjen paralele do të njoftohen individualisht nëpërmjet postës elektronike (e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë njësisë përgjegjëse, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.



f) Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi

Konkurrimi - intervista me gojë do të bazohet në njohuritë për specialitetin;

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005, *“Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Kodi i Procedurave Civile;
- Kodi i Procedurave Penale;
- Ligji nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*;
- Ligji për sistemin e taksave dhe procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

g) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen;

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit, përvoja dhe trajnimet.
- b) Intervista e strukturuar me gojë.

Kandidatët do të vlerësohen nga *“Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele”* i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë:
 - 20 pikë për përvojën;
 - 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet të lidhura me fushën përkatëse;
 - 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për rezultatet individuale të punës.
- b) 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

gj) Konkurrimi - testimi me gojë do të bëhet në mjediset e ILDKPKI në datën 7.11.2023 ora 10:00.

h) Mënyra e njoftimit dhe komunikimit

Lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve) do të komunikohet në datën 9.11.2023.

Njoftimi do të bëhet në portalin *“Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”*, si dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të ILDKPKI.

Nëse nuk ka fitues, për plotësimin e vendeve të lira, nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreut IV – “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar.

B. Ngritja në Detyrë

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, procedura do të vazhdojë me plotësimin e vendeve të lira të punës, me anë të konkurrimit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Ky informacion do të vendoset në dispozicion në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Edhe për këtë procedurë aplikohet në të njëjtën kohë.

- 1. Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse** (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në ILDKPKI, apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë. ILDKPKI ka vendosur që procedura e plotësimit të vendit të lirë për pozicionin Ndihmës Inspektor, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë.
- 2. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedurë janë:**
 - Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
 - Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
 - Të ketë të paktën dy vlerësimet e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.
 - Arsimi duhet të jetë në shkencat Juridike dhe/ose Ekonomike me diplomë “Master i Shkencave” apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të ketë një eksperiencë pune mbi 3 vjet në profesion dhe të ketë përvojë pune në fushat: juridike, financiare, bankare, tatimore, investigative dhe ato analitike;
- Të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike;
- Të ketë njohuri të mira në një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze;
- Të jetë individ me personalitet dhe integritet, me aftësi shumë të mira gjyqimi, analitike, hetimi dhe iniciativë për të marrë vendime komplekse;
- Të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
- Trajnime në lidhje me fusha që trajtojnë çështjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, si dhe të administratës publike në tërësi, auditimit, ekspertizës së vlerësimit të pasurive etj.

- Aftësi të drejtimit të punës në grup, aftësi gjykimi dhe hartimit të dokumentave të ndryshëm.

Kandidatët e tjerë nga jashtë shërbimit civil, duhet të plotësojnë;

a) Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndalij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

b) **Arsimi duhet të jetë Diplomë** në shkencat Juridike dhe/ose Ekonomike me diplomë “Master i Shkencave” apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë

c) **Kriterin e eksperiencës në pune mbi 3 vjet** në profesion dhe të ketë përvojë pune në fushat: juridike, financiare, bankare, tatimore, investigative dhe ato analitike

3. Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:
- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Një kopje të jetëshkrimit;
- Fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave;
- Një fotokopje e librezës së punës e plotësuar;
- Vërtetim i pagesës së kontributeve shëndësore dhe shoqërore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e tij;
- Të ketë dy vlerësimet e fundit të paktën “Mirë” ose “Shumë mirë”. Kandidatët nga jashtë shërbimit civil të kenë rekomandim nga punëdhënësi.
- Fotokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitje e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

4. Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër brenda datës 30.10.2023.

5. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **6.11.2023** do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpk.al. Këta do të jenë ata kandidatë që plotësojnë kushtet minimale të procedurës ngritje në detyrë dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë njësisë përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës.

6. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005 “*Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Kodi i Procedurave Civile;
- Kodi i Procedurave Penale;
- Ligji nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*”,
- Ligji për sistemin e taksave dhe procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen;

1. Vlerësimi i jetëshkrimit,
2. Vlerësimi me shkrim,
3. Intervista e strukturuar me gojë.

Kandidatët do të vlerësohen nga “*Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë*”, i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar,
- 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë,
- 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

Konkurrimi-testimi me shkrim do të bëhet në datën 20.11.2023, në mjediset e ILDKPKI, në orën 11:00.

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit

Lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve) do të komunikohet në datën 22.11.2023.

Kandidatë fitues janë kandidatët që marrin të paktën 70 pikë e lart.

Njoftimi do të bëhet në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpi.al.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të ILDKPKI.

ILDKPKI

NJËSIA PËRGJEGJËSE